



Prishtinë: 22.01.2013

Kodi i ZRRE-së: V\_499\_2013

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_884\_12\_12

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_884\_12\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 08.01.2013.

**Në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2013 nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.A. (shifra në KEK: DPR - 68828), nga fshati Sveqël, Besianë si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_884\_12\_12 i datës 10.12.2012.

### **Arsyetim**

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 18.04.2006 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit A.A. me shifër të konsumatorit në KEK DPR - 68828, dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja e energjisë elektrike njehsorin elektrik nr. 29983736 si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 41546106.

Me datë 10.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër të konsumatorit në KEK DPR - 68806, dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja e energjisë elektrike njehsorin elektrik nr. 41546106 si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 17702848. Prapë me datë 30.03.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut të Qendrës së Kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 41546106 dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes së energjisë elektrike.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 04.04.2010 e ka ngarkuar konsumatorin me shifër DPR – 68828 A.A. me faturë të energjisë elektrike prej 533.73 €, apo shpenzim mujore prej 5247 kWh.

Me datë 14.09.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse të konsumatorit kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR - 68828, ku kanë konstatuar se te ky konsumator më parë është faturuar për një muaj me 5,000 kWh ku ka qenë shkaktarë i rrymës së dobët dhe kohës e cila ka qen me reshje shiu dhe se gjatë murmurimave ka kërcy numërori i njehsorit dhe është faturuar për një muaj 500 €. Në procesverbal po ashtu është



kërkuar përmirësimi i gjendjes financiare të këtij konsumatori sepse shkaktar ka qenë rryma e dobët dhe për atë muaj të merret mesatarja e muajve të mëparme.

Pas parashtrimit të ankesës në Departamentin për Konsumator në KEK me datë 30.07.2012 i është përgjigjur konsumatorit duke e duke e refuzuar bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 008357 i datës 25.03.2010.

Konsumatori me datë 12.11.2012 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 10.12.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj shifrën DPR – 68828 nga fatura nr. 031084830 e datës 04.04.2010 në vlerë financiare prej 533.73€, gjithashtu është theksuar që për periudhën prej 10 ditëve (28.02.2010-10.03.2010) ta ngarkoj konsumatorin në shifër DPR- 68828 me 200 kWh, pasi që për këtë periudhë konsumatori ka bërë shpenzim të energjisë elektrike.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 08.01.2013 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEK-ut të theksuara në ankesë është për faktin se DMK, gjatë vendosjes së kësaj lënde ka bërë gabimisht vlerësimin e provave dhe shkresave të lëndës pasi që sektori i kalibrimit e ka konstatuar se njehsori elektrik regjistrimin e energjisë elektrike e ka brenda kufijve të lejuar, kundërshtimi tjetër është se procesverbali i përpiluar nga vetë punëtorët e KEK-ut, nr. 0547895, nuk mund të jetë meritore pasi që kemi një proces të lëshuar nga qendra e kalibrimit i cili ka vlerësuar se njehsori është në rregull. KEK gjithashtu ka theksuar se është zbatuar gabimisht dispozita ligjore nga se në bazë të kodit të matjes pika 5.11.2 ku thuhet se në raste të defekteve në matje duhet të rishikohet fatura duke u bazuar në shpenzimet mesatare të muajit paraprak kur njehsori mendohet të ketë qenë në rregull.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22 janar 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara, gjithashtu vlerësimin se procesverbali i lëshuar nga sektori i kalibrimit është proces meritore, kurse procesverbali nr. 0547895 i lëshuar nga vetë zyrtarët e KEK-ut, nuk mund të jetë meritore, gjithashtu mos zbatimi i drejt i dispozitës së nenit 5.11.2 të kodit të matjes. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha pikave të kundërshtimit konstaton se KEK, me rastin e atakimit të këtij vendimi bie në kundërshtim me vetveten pasi që procesverbali i theksuar më lart është një proces i përpiluar nga vetë zyrtarët e KEK-ut, e që janë plotësisht kompetent për atë se çka kanë lëshuar dhe vlerësuar për këtë pikë matëse në momentin se kur është shkaktuar defekti në njehsor ku edhe është bërë kërcimi i kilovatëve dhe është e palogjikshme që një konsumator shtëpiak të faturohet me 5,000 kWh për një muaj këtë fakt nuk e mohojnë as vetë ekipet e KEK-ut, që kanë dalë në teren. Gjithashtu edhe në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik i datës 18.04.2006 është theksuar se releu tarifor shkaktonte dridhje dhe se nevojitet të bëhet shqyrtimi dhe kalibrimi i njehsorit. Konstatimet e tilla të theksuara në ankesë vejnë në dyshim faktin se cilit proces duhet besuar për vendosjen e kësaj çështje pasi që kemi të bëjmë me disa procese zyrtare të lëshuar nga vet zyrtarët e KEK-ut të cilët tregojnë një gjendje reale të njehsorit elektrik.

Sa i përket moszbatimit të drejt të nenit 5.11.2 të Kodit të matjes Bordi i ZRRE-së, ka analizuar se DMK, ka vepruar konform dispozitave këtij neni pasi që për muajin kontestues kur është bërë kërcim i kilovatëve ka ngarkuar konsumatorin me mesatare të shpenzimit prej 200 kWh, andaj nuk kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të këtij neni dhe se konstatimet e KEK janë plotësisht të pabaza.



Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se KEK ka ra në kontradiktë edhe në pikën 2 të ankesës së tij, ku thuhet se Procesverbali i shqyrtimit të njehsorit është proces meritator i cili proces e vërteton se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar, ndërsa në anën tjetër thirret në nenin 5.11.2 të Kodit të matjes ku thuhet se në rastet kur konstatohet se njehsori ka gabuar 100% duhet të kalkulohet mesatarja paraprake e shpenzimit të konsumatorit, andaj me këtë rast vihet dilema se njehsori elektrik a paska qenë në gjendje të rregullt a po jo dhe se cilës pikë të kundërshtimit të KEK-ut duhet besuar.

Bordi i ZRRE-së konsideron se DMK ka vepruar konform dispozitave ligjore, në rastin e aprovimit të ankesës së konsumatorit A.A të cilën ka kërkuar nga KEK-u që të shkarkojë nga borxhi i krijuar në vlerë prej 533.73€, si pasojë e kërcimit të kilovatëve për shkak se njehsori nuk ka qenë në gjendje të rregullt, si dhe ka vendosur që për periudhën prej 10 ditëve (28.02.2010 - 10.03.2010) ta ngarkoi me 200 kWh pasi që për këtë periudhë kohore konsumatori ka bërë shpenzim të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla janë të papranueshme për Bordin e ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.01.2013 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_884\_12\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar